

NJË VIT SUKSESI DHE ANGAZHIMI PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Dhjetori mbyll një vit të jashtëzakonshëm për Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, duke kurorëzuar një kalendar të mbushur me aktivitete, projekte restaurimi, dhe gërmime arkeologjike në të gjithë Shqipërinë. Gjatë vitit 2024, IKTK ka kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore përmes ndërhyrjeve konservuese/restauruese në monumente të ndryshme, eventeve edukative dhe promovuese, si dhe projekteve kërkimore që pasurojnë dijet mbi historinë dhe kulturën shqiptare. Muaji dhjetor u shënua me vijueshmërinë e punimeve, organizimin e eventeve të fundvitit dhe aktiviteteve që përforcojnë misionin tonë për ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore.



PROJEKTE RESTAURIMI QARKU GJIROKASTËR



Në qarkun e Gjirokastrës po realizohen një sërë projektesh restaurimi me rëndësi të veçantë për ruajtjen dhe promovimin e pasurisë sonë kulturore.

Projekte aktualisht në proces në Monumente Kulture të Kategorisë I-rë:

- Restaurimi i Urës së Mesit pjesë e Tri Urave të vogla mbi përroin e Zerzebitit
- Ndërhyrje emergjente për "Urën mbi Përroin e Benjës"
- Restaurimi i Urave të Kollorcës, Glinës dhe Haskovës
- Restaurimi i murit perëndimor në "Banesën Fico"
-

Projekte që pritet të nisin:

- Restaurimi i "Kishës së Manastirit të Shën Mëri Spilesë"
- "Banesa e Angonatëve"
- "Sarajet e Myfit Beut", në Libohovë
- Kisha e Manastirit të Shpërfytyrimit, në fshatin Çatistë.

Në bashkëpunim me CHWB, janë duke u restauruar kishat përgjatë Luginës së Drinos:

- Manastiri i Shën Qirjakut dhe Julitës në Dhuvjan
- Manastiri i Ungjëllizimit në fshatin Vanistër

Në bashkinë Përmet është duke përfunduar restaurimi i:

- Kishës së "Shën e Premtes"

Mbrojmë trashëgiminë kulturore, rrisim atraktivitetin turistik dhe kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.



PROJEKTE RESTAURIMI QARKU DIBËR

Në qarkun e Dibrës po realizohen një sërë projektesh restaurimi me rëndësi të veçantë për ruajtjen dhe promovimin e pasurisë sonë kulturore.

Projekte aktualisht në proces në Monumente Kulture të Kategorisë I-rë:

- Restaurimi i Xhamisë së Allajbegisë, Peshkopi
- Restaurimi i Kishës së Shën Sotirit, Kërçisht
- Restaurimi i Kishës së Shpërfytyrimit, Herbel

Projekte që pritet të nisin:

- Restaurimi i Banesës "Mustafa Shehu", Zerqan

Mbrojmë trashëgiminë kulturore, rrisim atraktivitetin turistik dhe kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.



PROJEKTE RESTAURIMI QARKU KORÇË



Trashëgimia kulturore në qarkun e Korçës merr vëmendjen e merituar!

Në bashkëpunim me DRTK Korçë, vijojnë punimet në disa monumente kulturore të kategorisë së parë:

- Muzeu Etnografik Elbasan,
- Muzeu Arkeologjik Korçë,
- Stacioni Rrugor Ad Quintum (Gërmadhat Antike).

Këto projekte synojnë ruajtjen e historisë dhe vlerave të pasura të trashëgimisë sonë kombëtare.




KISHA E SHËN NIKOLLËS VUNO

Kisha e Shën Nikollës ndodhet në pjesën e sipërme të fshatit Vuno, Himarë, dhe është shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë në vitin 2015. E ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje, ajo i përket tipit të kishave me një nef, me apsidë të rrumbullakët dhe afreske të vitit 1783. Deri më tani nuk kishte pasur ndërhyrje restauruese.

Pikat kryesore të projektit restaurues:

- Çati e re me tjegulla vendi.
- Restaurim dhe konsolidim strukturor i muraturave prej guri.
- Pastrim dhe fugatim i murit.
- Restaurim i kornizave dhe dyshemesë me gurë.
- Ringritje e kambanares dhe ndërtim trotuari me kalldrëm.
- F.V. dyer dhe dritare druri.

Projekti synoi rikthimin e kishës në një gjendje funksionale dhe mbrojtjen e vlerave të saj historike dhe arkitektonike.




PROJEKTI ARKEOLOGJIK I SHKODRËS (PASH)

Lajm i shkëlqyer për arkeologjinë shqiptare!

Projekti Arkeologjik i Shkodrës (PASH), një bashkëpunim mes  Universitetit të Michigan-it dhe  Universitetit të Tiranës, ka fituar çmimin prestigjioz Anna Marguerite McCann Award for Fieldwork Reports 2025 nga Instituti Arkeologjik i Amerikës (AIA). Projekti, i drejtuar nga Michael L. Galatey dhe Lorenc Bejko, përqendrohet në studimin e ndryshimeve të vendbanimeve dhe sjelljeve sociale nga parahistoria deri në ditët e sotme.

Rezultatet përfshijnë studime mbi tre vendbanime, tre tuma, artefaktet/objektet prej qeramike dhe guri, si dhe analiza të izotopeve faunale e petrografike. Këto gjetje janë thelbësore për avancimin e kërkimeve arkeologjike.



PROJEKTE RESTAURIMI XHAMIA E PLUMBIT



Restaurimi i Xhamisë së Plumbit, Shkodër

Puna për restaurimin e Xhamisë së Plumbit po vijon me përkushtim për të ruajtur vlerat unike të këtij monumenti historik. Me ndërhyrje delikate dhe teknika të avancuara, synojmë të rikthejmë shkëlqimin e saj të dikurshëm, duke respektuar autenticitetin arkitektonik dhe historinë që mbart.

Në fokus: Stabiliteti i strukturës, ringritja e minaresë dhe mbrojtja ndaj faktorëve natyrorë.



VENDIM PËR PËRDMITËSIMIN E MANUALIT TË RESTAURIMIT

Lajm i shumëpritur për trashëgiminë kulturore!

Manuali i përditësuar i Restaurimit, i miratuar në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, vjen si një udhërrëfyes i pasuruar me zëra të rinj dhe i përafruar me çmimet e tregut. Ky dokument thelbësor do të shërbejë si bazë për ndërhyrje restauruese cilësore në pasuritë tona kulturore.



BAZILIKA PALEOKROSTIANE EXTRA MUROS



Kanë nisur sërish gërmimet arkeologjike në Bazilikën Paleokrostiane Extra Muros në Elbasan nga Instituti i Arkeologjisë.

Punimet edhe këtë vit drejtohen nga arkeologu Elio Hobdari së bashku me një grup studentësh të arkeologjisë nga Universiteti i Tiranës.

Gërmimet do të përqëndrohen në disa pika të monumentit; në nefet e bazilikës, në narteks dhe në ambiente të tjera të parashikuara nga drejtuesi i gërmimeve.



PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE E HADRIANOPOLI

Në Parkun Arkeologjik Antigone e Hadrianopoli, vijon kujdesi i vazhdueshëm me punime të vogla mirëmbajtjeje, si sistemimi i mureve të brendshme dhe heqja e bimësisë, për të garantuar ruajtjen dhe jetëgjatësinë e tyre.



FESTA E FUNDVITIT

Atmosferë festive në IKTK!

Në prag të fundvitit, ambientet tona u mbushën me buzëqeshje dhe gëzim, ndërsa dhuratat e veçanta u shpërndanë për fëmijët e stafit. Së bashku festuam shpirtin e festave me momente të paharrueshme dhe shumë dashuri!

